



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 6085/11 Prot.,

Lezhë, më 23.05.2025

SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit nr.649, datë 16.10.2024. Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, VKB nr. 112 datë 29.06.2021 “Për krijimin e Shoqërisë “Lezha Invest” SH.P.K si Përsôn Juridik në Pronësi të Bashkisë Lezhë”, Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme Nr. 10 Datë 07.04.2025 “Për miratimin e planit të menaxhimit të plazheve publike në Bashkinë Lezhë”, Vendimit nr 11 date 07.04.2025 “Për miratimin e strukturës dhe emërtimet e pozicioneve, klasat për cdo pozicion pune për administratën e Lezha Invest Shpk, Bashkia Lezhë dhe Lezha Invest sh.p.k, shkresës datë 22.05.2025, protokolluar nga ana jonë me nr.6085 prot., datë 22.05.2025, me lëndë “Kërkesë për mbështetje në rekrutimin e stafit”, të Lezha Invest SH.P.K, njofton për shpalljen e procedurave për vende të lira pune për pozicionet:

- Përgjegjës i Sektorit të Plazheve, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve - Kategoria III-2.
- Specialist Jurist, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve - Kategoria IV-2.
- Inspektor Kontrolli, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve - Kategoria IV-2.
- Roje plazhi (Lifeguard)që të jenë të licensuar nga Shoqata Kombëtare e Vrojtuesve.
- Punonjës Sezonal, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Plazheve, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve është:

- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit të sezonit turistik për plazhet që administron Lezha Invest Sh.p.k..
- Është përgjegjës për organizimin, kordinimin dhe drejtimin e punës brenda Sektorit duke bërë ndarjen e detyrave për punonjësit e Sektorit si dhe duke mbikqyrur dhe siguruar kryerjen e detyrave në kohë dhe me cilësi nga ana e punonjësve.

- Realizon ndarjen e punës, jep instruksione dhe ndihmën e domosdoshme për vartësit direkt për përmbushjen e detyrave.
- Siguron marrëdhënie të rregullta komunikimi me punonjësit e Sektorit duke garantuar vazhdimësinë e operacioneve të punës nëpërmjet transparencës në transmetimit të urdhërave;
- Analizon mbarëvajtjen e përmbushjes së detyrave nga ana e Sektorit, informon drejtpërdrejt Administratorin mbi punën kryer si dhe paraqet çdo problematike sipas rregullorës dhe legjislacionit në fuqi;
- Zbaton detyrat e ngarkuara sipas rregullores në fuqi si dhe të planeve të punës të miratuara nga Administratori i Lezha Invest Sh.p.k;
- Mbikëqyr respektimin e kuadrit rregullator nga ana e punonjësve;
- Këshillon dhe orienton punonjësit e Sektorit që drejton me qëllim realizimin e suksesshëm të detyrave.
- Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Administratori i Lezha Invest sh.p.k,në përputhje me misionin dhe objektivat e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme “Për miratimin e planit të menaxhimit të plazheve publike në Bashkinë Lezhë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë në Shkenca Shoqërore, niveli minimal Master Profesiona. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Jurist / Protokollist / Arshivist, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve është:

- Ofron këshillim juridik për eprorin sipas fushës së funksionit dhe misionit të njësisë organizative.
- Koncepton shkresa, akte në fushën e sektorit që mbulon.
- Koncepton kthim përgjigje.
- Shyrton kërkesat e ardhura në Shoqërinë Lezha Invest sh.p.k .
- Përgatit memo informuese mbi ecurinë e punës së sektorit për Administratorin e Shoqërisë,
- Bën regjistrimin, protokollimin, shpërndarjen e kërkesave, ankesave gjithë korrespondencave të tjera zyrtare konform ligjeve në fuqi

- Pranimi i postës së jashtme, hapja e zarfeve dhe regjistrimi i shkresave në librin e protokollit;
- Pranimin e shkresave, arshivim dhe nisje me postë;
- Përgatit shkresat për në postë dhe bën regjistrimin e tyre;
- Marrja dhe analizimi i dokumenteve për të përcaktuar afatet e mbajtjes sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse;
- Kërkimi dhe nxjerrja e dokumentave sipas kërkesave;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë në Shkenca Juridike, niveli minimal Bachelor. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Inspektor Kontroll, në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve është:

- Eshtë përgjegjës për zonën e plazhit në menaxhim duke kontrolluar punonjësit çadrave dhe punonjësit të pastrimit .
- Eshtë përgjegjës për zonën e plazhit në menaxhim duke kontrolluar rojet e plazhit (lifeguard)
- Eshtë përgjegjës për kontrollin e pastrimit dhe shërbimit të ofruar ndaj pushuesve

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal Bachelor. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë dokumentacionin pranë Sportelit të Zyrës me një Ndalesë në Bashkinë Lezhë si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë diplomën bachelor dhe masterit, e noterizuar);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Dëshminë e Penalitetit;
- g- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 29.05.2025.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Roje plazhi (Lifeguard) që të jenë të licensuar nga Federata Shqiptare e Vrojtuesit të Plazhit dhe Shpëtimit në Ujë është:

- Duhet të jetë i angazhuar vetëm në shërbim të vrojtimit-shpëtimit
- Gjate shërbimit, duhet të mbajë të veshur uniformën e vrojtuesit me ngjyre te kuqe.
- Duhet të lajmërojë pranë organeve kompetente, në rastet kur verifikohen kundravajtje në territorin e stacionit të plazhit dhe në hapësirën ujore perballe tij.
- Duhet të kujdeset periodikisht për sinjalistikën ujore dhe territoriale të stacionit të plazhit.
- Duhet të bejë zëvendësimin e materialeve të konsumuara në kutinë e ndihmës së shpejte mjekësore, si edhe të mbajë në efikasitet mjetet e shpëtimit.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë leje aktive nga institucionet përgjegjëse për ushtrimin e këtij pozicioni pune sipas legjislacionit në fuqi Rojet e Plazhit.

• Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Punonjës Sezonal , në Sektorin e Menaxhimit të Plazheve është:

- Përgjigjet për mirëmbajtjen e stacioneve të plazhit dhe të çadrave.
- Qëndron në gatishmëri të plotë për të ndërhyrë për mbajtjen në funksionim të plotë të paisjeve/mjeteve të punës.
- Të raportojë tek mbikëqyrësi për detyrën e kryera.
- Zbaton parimet e punës në grup.

- Pastron vendin dhe mjetet e punës pas mbarimit të punës.
- Planifikon kërkesat për materiale për riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe ambjenteve të dëmtuara.
- Të njohë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës dhe mbrojtjen kundra zjarrit në vendin e tij të punës.
- Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

Rezultatet për fazën e verifikimit

Pas verifikimit të dokumentacionit, Bashkia Lezhë do të shpallë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të kërkuara si më sipër. Kandidatët e kualifikuar në lidhje me dokumentacionin e paraqitur do të njoftohen, për datën, vendin dhe orën e intervistës.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

